



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Rahovec, e mbajtur më 19.05.2022 me fillim në ora 15.30. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi. **Kryetari**- Më lejoni t'i përshëndes të gjithë anëtarët e KKSBB, përshëndes nënkyretarin e komunës, Fatmir Iska, drejtoret e drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovecit z. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e tretë e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Përpara e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2022 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Shqyrtimi i dukurive negative, me theks të veçantë trajtimi i objekteve jo të sigurta në Komunën e Rahovecit,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave përluftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,
3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror;
4. Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike;
5. Të ndryshme.

Kryetari - A ka dikush të shtoj diçka sa i përket rendit të ditës, nëse jo atëherë po e vendosim në votim. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit.

Kryetari – Do t'i dëgjojmë me vëmendje informacionet dhe njofimet që do të jep komandanti i stacionit të policisë, kapiteni Fazli Morina dhe pastaj mund të futemi në debat. Në përgjithësi situata sipas asaj që ne jemi në dijeni gjendjeje në komunën e Rahovecit është stabile dhe e qëndrueshme. Unë po e hapi

debatin dhe ia kaloj fjalën kapitenit Fazli Morina dhe besoj qe ai ka shumëçka pér tē thënë dhe ndodhitë ndërmjet dy mbledhjeve të KKSBB-së.

Fazli Morina – Përshëndetje pér tē gjithë tē pranishmit, tē nderuar do ju paraqes një raport tē shkurtër rrëth sigurisë së përgjithshme pér periudhën 21 mars – 18 Maj. - Gjatë periudhës reportuese Situata e sigurisë ne Komunën e Rahovecit ka qenë e qetë dhe stabile. Gjatë kësaj periudhe, në S.P. Rahovec janë regjistruar gjithsejti: 98 Raste vepra penale , 9 incidente jo penale. Nga këto raste mund tē veçojmë disa vepra më tē rënda: Vjedhje, 10 raste, vjedhje tē rënda, 10 raste, dhunë në familje, 13 raste, armë mbajtje pa leje, 05 raste. Lidhur me rastet e cekura, nga njësitet kompetente në kuadër tē stacionit policor në Rahovec dhe Hetimeve Rajonale ne Gjakovë, janë ndërmarr tē gjitha veprime e nevojshme. Sa i përket Sigurisë komunikacionin rrugor, nga S.P Rahovec vazhdon te implementohet P.O “Siguria në trafikun rrugor”, ku ne kuadër te këtij plani gjate periudhës reportuese nga patrullat policore te S.P Rahovec, janë shënuar: 1287 Gjoba ne trafik, 3 kundërvajtje PRQP. Siguria në shkolla, gjatë periudhës reportuese, në kuadër tē planit vjetor dhe agjendës planifikimit mujor tē S.P Rahovec pér prezantime në shkolla, janë mbajtur disa aktivitete vetëdijësuese preventive përmes mbajtjes se ligjëratave pér nxënësit e klasave prej III-IX, me temat „Bullizmi dhe masat parandaluese“ “Siguria e qarkullimit tē këmbësorve në trafik”, “Parandalimi i nxitjes pér krimet e urrejtjës” dhe “Parandalimi i ekstremizmit dhe radikalizmit tē dhunshëm” ku janë përfshirë rrëth 1000 nxënës nga 16 shkolla fillore te komunës sonë. Këto aktivitete do te zhvillohen ne vazhdimësi, pér çdo muaj me prezantimin e temave te ndryshme sipas planit vjetor. Sa i përket rasteve në shkolla, gjatë periudhës reportuese, në shkollat e zonës tonë tē përgjegjësisë, nuk është raportuar asnjë rast. Ju faleminderit pér vëmendje, nëse keni ndonjë pyetje jam këtu pér tē ju përgjigjur.

Kryetari – Faleminderit komendant, e hapim debatin rrëth gjendjes së përgjithshme tē sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit, me siguri keni ndonjë koment rrëth asaj që tha komandanti i stacionit policorë.

Egzon Hamza – përfaqësues i komunitetit egjiptian. I nderuar kryetar, javë më parë iu kam informuar që lagjja jonë rr.”Sylejman Kollari” e gjitha është në errësirë që prej natës së Bajramit, gjithashtu kam kontaktuar edhe me z.Përparimin. Kam kërkesë prej banorëve tē iu parashtroj publikisht pyetjen dhe tē na tregoni problemin se çka po ndodh me atë ndriçim edhe pse z.Lendrit Qelit i kanë thënë qytetarët se ndriçimi nuk funksionon, por përgjigja e tij ishte që keku qëllimi shëndetësor e ka ndalur. Nuk e di a është problemi te kompania përkatëse apo te kedsi, mirë kishte me qënë qe si i pari i komunës që jeni, tē na jepni një përgjigje. Publikisht si anëtar i këshillit tē sigurisë kërkoi që sa më shpejtë me mundësi tē rikthehet ndriçimi publik në atë pjesë te lagjja Sylejman Kollari deri te kisha serbe, sepse duke marrë parasysh që është kohë vape, aty mblidhen njerëzit d.m.th frekuentohet shumë dhe ekziston frika që mund tē vie te ndonjë kacafytje, përlleshje apo krim i organizuar, gjithashtu edhe policia është në dijeni sepse ajo lagje është mjaftë e njohur pér policinë.

Fadil Sylka – Përshëndetje pér tē gjithë, desha tē kyçem rrëth organizimit tē fundviteve tē maturantëve. Mendoj që organizimi i maturës duhet tē mbahet në një lokal sa më afër e jo ato tē largëta. Nëse arrihet ky qëllim, gjithashtu tē organizohet transporti me autobus dhe jo me vutura sepse ka maturant pa patent shofer që kur tē kthehet mund tē jetë në ndikim tē alkoolit gjë që mund tē ndodh ndonjë aksident, pikërisht ta evitojmë këtë gjë dhe ta bëjmë organizimin me autobus nën kontroll tē profesorëve.

Bujar Morina – desha tē bejë një kërkesë apo apel në drejtorinë e arsimit, kisha pas kërkesë që organizata “Syri” e romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve tē mos ketë më aktivitete nëpër shkollat tonë, duke parë rastin e para 2-3 dite i cili ndodhi në Pejë duke diskriminuar femijët e komuniteti RAE që tē mos vie puna tē ndodh edhe në komunën tonë, sepse ajo paralele që ndahet veç mund tē ketë edhe pasoja, racizëm dhe diskriminim. Para një muaji duke kaluar afër shkollës tonë “Katër dëshmorët” një femijë i moshës 10 vjeçare i tha femjës së komunitetit egjiptian që ju e keni klasën e juaj dhe kjo me tē vertetë është bullizëm dhe diskrimini pér këtë arsy pér mendimin tim është mirë që kjo organizatë tē mos ketë aktivitete në shkollat që është duke mbajtur mësim.

Ersekë Cana – tē nderuar tē pranishëm, i nderuar kryetar i komunës Smajl Latifi, une si kryetare e këshillit tē prindërve në nivel komunal, pas dy mbledhjeve në ministrinë e arsimit në përzgjedhjen e bordit tē anëtarësisë tē këshillit tē prindërve në nivel regional dhe në nivel shtetëror, diskutuan se si po rrijedhë

puna në angazhimin në nivel komunal, aty raportova qe kam mbështjetje nga DKA dhe të anëtarëve të tjerë që e përbëjnë këshillin e prindërve në nivel komunal. Gjatë diskutimit me kolegë tjerë që veprojnë e jetojnë në komuna tjera e që janë anëtarë të KKSBB-së, kuptova që një pjesë e madhe e tyre nuk mbajnë mbledhje të rregullta si ne që i organizojmë me rregull në komunën tonë, gjithashtu e theksoj që këshilli i prindërve ka rëndesi shumë të rëndësishme në ndikimin e sistemit dhe cilësisë së arsimit bashkë me angazhimin e komunës dhe DKA-së. Dua të raportoj që kemi mbajtur dy takime në shkollën "Isa Boletini" dhe në qerdhen "Tulipanët". Kryesia së bashku me anëtarët kemi formuar edhe një plan të mbështetur në udhëzimin administrativ dhe në trekëndëshin didaktik. Në plan e kemi të vizitojmë edhe shkollat e tjera të komunës për ta rritur bashkëpunimin me çdo shkollë në komunën tonë dhe poashtu më tutje do të vazhdojmë hartimin e planit dhe do të jemi kontributdhënes në sigurim në shkolla dhe në sigurinë e përgjithshme publike. Duke iu uruar punë të mbarë, faleminderit qe më dëgjuat.

Milan Stanojeviq – Për qështjen e pengesave në rrugë, kemi parashtruar kërkeshën te z.Përparim Krasniqi, meqë nuk është këtu, po iu drejtohem juve, çfarë keni bërë në këtë drejtim meqë na keni premtuar?

Fazli Morina – kam një kërkeshë që e anashkalova, e kam potencuar edhe në takimet e kaluara, është çështja e ceremonive të varrimit në varrezat e qytetit në Rahovec. Hiç më larg se dje ose pardje, me minuta të tërë rruga është e bllokuar, nuk jam kundër kësaj e di që është vdekje dhe situatë e rendë, mirëpo edhe ky është problem i yni, mos dhashtë zoti të ndodh ndonjë fatkeqësi, çoftë rast shëndetësor, ndonjë e keqe ose zjarr e kemi të pamundur qarkullimin në atë pjesë të rrugës, kështu që duhet të bëjmë një zgjidhje rreth kësaj.

Avni Morina – Përshëndetje për të gjithë anëtarët e KKSBB-së, i nderuar kryetar. Pata dy pyetje që lidhen me aktivitetet e nxënësve dhe të shkollave në komunën tonë, e para ishte rreth organizimit të mbrëmjes së maturës, është udhëzimi administrativ nga ministria e arsimit që e ka rregulluar, mbrëmja e maturës mund të mbahet brenda territorit të komunës. Unë jam në dijeni që para disa viteve janë mbajtur edhe në komunat tjera, si mësimdhënës prej 98-99 që jam, e di që kemi mbajt në Prizren dhe në Gjakovë, mirëpo prej atëherë vetëm brenda komunës sonë, ndërkaq nuk kemi ndonjë udhëzim tjetër që thotë vetëm brenda vendbanimit duhet të mbahet mbrëmja e maturës. Përderisa nuk kemi udhëzim, nuk kemi të drejt të iu mohojmë mbajtjen e maturës në Xërxe, në Fortesë apo diku andej në Kramovik apo kudo që është restauranti. Sa i përket përcjelljes, këtë mesazh do ta përcjellim edhe te drejtorët e shkollave dhe te këshilli drejtues i shkollave duke inkurajuar edhe këshillin e prindërve për angazhim në këtë drejtim, nëse organizimi i maturës bëhet më larg, atëherë ta praktikojnë shkuarjen dhe kthimin e organizuar.

Ndërsa sa i përket qendrës arsimore, pyetje nga Bujar kushëri. Qendra arsimore në Ratkoc në shkollën "katër dëshmorët" për fëmijët e komunitetit romë ashkalinjë egjiptas është qendër e themeluar me vendimin e ministrisë së arsimit dhe në procesin e themelimit të kësaj qendre na kanë ndihmuar edhe shoqata "Zëri i Romë ashkalinjë egjiptas". Kjo qendër nuk mbanë mësim të rregullt siç mbajnë mësim të gjithë nxënësit e asaj shkolle prej parashkollores deri te klasa e nëntë, por është mësim plotësues-shtesë dhe në atë klasë nuk e kanë të ndaluar të shkojnë edhe nxënësit e komuniteteve shumicë d.m.th. është mësim shtesë që organizohet përfshirët e të gjitha komuniteteve, prandaj ne nuk mund të dalim kundër një vendim që ka qenë vullnet i përbashkët përfshirët e të themeluar një qendër arsimore që i dedikohet fëmijëve që mund të kenë ngecje në proceset mësimore. Edhe një specifikë përfshirët që kemi arsimore është fakti që aty mund të shkojnë nxënësit e të gjitha klasave-moshave, aty janë rreth 25 nxënës të moshave - gjeneratare të ndryshme dhe deri tanë nuk kemi hasur në probleme, mund të ketë ndonjë ngacmim të rastit që mund të eliminohet me angazhimin e mësimdhënësve që punojnë aty.

Kryetari – programet që ndikojnë në rritjen e sigurisë në shkolla nga ana e policisë do të vazhdojnë dhe do të ketë aktivitete të ndërthurura me organizata të tjera; S.H.L Kosova por edhe komuna do të bëjë punën e vet në bashkëpunim në mënyrë që të kemi siguri më të madhe nëpër shkolla. Kamerat e sigurisë janë një mekanizëm jashtëzakonisht i rëndësishëm që ndikojnë në rritjet e sigurisë në shkolla. E dëgjuam komandantin që janë duke hartuar planet operative që kanë të bëjnë me grumbullimin e madh të nxënësve në theks të veçantë të maturantëve tanë në prag të ekskursioneve dhe maturës, janë qështje që rregullohen në koordinim me policinë, drejtorët e shkollave, organet drejtuese të shkollave të mesme, drejtorinë komunale të arsimit dhe këshillin e prindërve. Kjo qështje u ngrit nga Fadil Sylka dhe besoj që mund të

rregullohet lehtë dhe nuk besoj që ka mungesë përvoje për t'a trajtuar me seriozitet. Pas pandemisë kuptohet që ka një liri më të madhe të lëvizjes, veprimit dhe grumbullimit të njerëzve, ka rritje të organizimeve të ekskursioneve që është shumë normale sidomos pas asaj bllokade ose kufizimeve dy vjeçare shkaku i pandemisë dhe besoj që do të operojmë me sukses në përballimin e këtij "liberalizimi" të qytetarëve.

Tjetër, me "Syri vizion" dhe me "Zerin e romëve ashkalinjëve dhe egjitasve" kemi memorandum mirëkuptimi dhe pavarësisht shqetësimit të ngritur të Bujarit, nuk duhet të paragjykojmë as une e as ti, sepse janë organizata të cilat e ndihmojnë procesin e edukimit, integrimit, arsimimit të nxënësve të cilët kanë ngelur mbrapa dhe meqenëse ka ndodh në Pejë do të ndodh edhe te ne, të paktën nuk kemi burim informacioni që do të ndodh edhe te ne. Jemi distancuar të gjithë edhe opinioni publik edhe institucionet dhe këtij solidariteti po i bashkohemi edhe ne në këtë mbledhje të KKSBB-së, mirëpo unë nuk ç'nënshkruaj memorandume meqenëse ka ndodhur në Pejë e tanë të ia ndalojmë aktivitetin te ne. Vazhdon punën "Syri vizion", vazhdon punën qendra arsimore në Ratkoc madje ne jemi duke u mundur ta avansojmë dhe pasurojmë sepse kemi vendim nga DKA dhe ligjet e aplikueshme dhe në fund të ditës e kanë një burim pra kushtetutën e republikës së Kosovës. Te pyetja e Milanit, sa i përket pengesave në rrugë, për hire të punës se madhe që bëjnë policia e e republikës së Kosovës, policia e stacionit në Rahovec që kujdesën për sigurinë dhe rendin publik për të gjithë, pengesave në rrugë nuk duhet ti themi "policë të vdekur", por vetëm pengesa në rruge. Jemi në prag të lidhjes së kontratës së re, kërkesa për vendosjen e pengesave në rrugë është miratuar dhe së shpejti do ti vendosim në rrugë. Komandanti i stacionit, kapiteni Fazli Morina edhe një herë e ka aktualizuar temën e bllokimit të rrugës gjatë varrimit, kur kemi situata të tilla bllokohet rruga kryesore së paku 20minuta, që është shumë e vërtetë dhe kjo shkakton telashe, jo qe skemi rrugë alternative po konfiguracioni i qytetit asisoji që nuk mund të hyjmë në rrugë alternative. Unë jam pro shqyrimit, jam dakord që funerali dhe njerzit që shkojn për respekt te të vdekurit ta gjejnë mundësinë e një rruge tjetër sepse në rrugë kryesore shkaktohet telashe në mosfunkcionit të institucioneve me peshë të veçantë siç është policia, zjarrfikësit, komuna, gjykata pra janë institucione të rëndësishëm së veçantë. Do t'i shohim mundësitë t'a bëjmë një rrugë që shfrytëzohet për raste të tilla dhe t'i shhangem bllokimit të përkohshëm të rrugës kryesore. Faleminderit Ersekë për angazhimet që i keni kryetare e këshillit të prindërvë, më vjen mirë qe keni pas takim në nivel vendi me kryetarët e këshillave të prindërvë të komunave të republikës së Kosovës dhe më vie mirë qe keni nisë një vazhdë të takimeve nëpër të gjitha shkollat, sepse ky rol është shumë i vlefshëm në funksionimin më të mirë të të gjithë procesit edukativo-arsimorë në komunën tonë.

Lagja në errësirë, Lendrit Qeli është shef i zyrës komunale për komunitete dhe kthim statusi i tij është gati si status i drejtitorit, është i zgjedhur me konkurs dhe është shërbyes civil. Adresa e parë e komunikimit dhe e paraqitjes së problemeve është zyra komunale për komunitete në këtë rast Lendriti si shef i zyrës. Por natyrish që për këtë problem kemi dëgjuar, aty ka problem me siguresa të cilat vijnë nganjëherë si rezultat i mbingarkesës, nganjëherë si rezultat kur dikush e prek siguresën dhe e ndal rrymën për të gjithë lagjen. Kompaninë për mirëmbajtjen e ndriçimit publik e kemi ftuar të vijnë, nuk më vie turp të them që ne kemi vështirësi si komunë për shkak të rritjes së çmimeve dhe kontratat qe i kemi nënshkruar më herët përballemi me hezitime te kompanitë, megjithatë kompania vjen dhe do t'i zgjidh problemet me mirëmbajtje dhe me instalim të ri të ndriçimit publik aty ku nuk kemi. Sa i përket problemeve tjera që lidhen me siguri në lagje, iu kisha lutur të adresoheni te policia e Kosovës. Qështjet e rendit publik, qetësisë publike, keqbërësve, kundërvajtjeve, veprave penale, institucionet për këtë arsyë i kemi aktive në këtë drejtim.

Kemi filluar dhe vazhdojmë aksionin për lirimin e hapësirave publike, trotuareve, lirimin e hapësirave publike nga uzurpimet arbitrale, kemi edhe shembuj konkret të aksioneve të inspektoratit të komunës në bashkëpunim me policinë e stacionit në Rahovec. Jemi duke bërë përpjekje për lirimin e trotuareve duke moslejuar eksposimin e mallrave ushqimore pranë dyqaneve, ka një përmirësim të dukshëm të situatës dhe njëkohësisht ka tentativë për eksposim ne forma të ndryshme në menyrë të paligjshme mallrat ushqimore pranë dyqaneve. Ky aksion dhe aksionet e tjera do të vazhdojnë dhe do të jetë më intenzivë. Jam i lumtur që së paku e kemi pastruar një hapësirë që nuk i ka dhënë shije të mirë qytetit, ajo te stacioni i autobusëve.

Do të kemi veprime të tilla posaçërisht në Krushë të Madhe, në Xërxe, në Ratkoc dhe kudo tjetër nëse në shënimet tona zyrtare del që është usurpim ose keqshfrytëzim të paligjshëm. Sa i përket situatës së sigurisë në përgjithësi kemi pas ankesa edhe për qentë endacak si dhe për funksionalizimin e plotë të kamerave të sigurisë dhe shtimin e pajisjeve të kësaj natyre dhe besoj që dita e ditës qëndrueshmëria e situatës së sigurisë po vjen duke u rritur dhe stabiliteti i saj do të ndihmohet nga qytetarët, policia, kksb-ja, si dhe nga organet tjera profesionale përmes programeve të ndërgjegjësimit nëper shkolla etj... Kalojmë në pikën e tretë se u vonuam shumë në të dytën. **3. Parapërgatitje dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin e zjarreve gjatë sezonit verorë.**

Kujtim Dina – Faleminderit i nderuar kryetar i komunës dhe kryesues i KKSB-së z.Smajl Latifi, të nderuar anëtar të këshillit komunal për siguri dhe bashkësi. Në bazë të përvojave të cilat i kemi pasur në vitet e kaluara dhe gjasave reale që mund të përballemi me temperaturat e larta gjatë periudhës korrik-shtator ku mund të kemi zjarre fushore-malore në numër më të madh, ne si drejtori për mbrojtje dhe shpëtim i kemi bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme sa i përket mjeteve dhe pajisjeve teknike për intervenim. Në gjendje gatishmërie i kemi pesë kamionë për zjarrfikje, tre automjete tjera për intervenim si dhe paisje tjera të nevojshme për punë. Në rast të ngritjes së gatishmërisë emergjente dhe shpalljes së mobilizimit nga ana e kryetarit të komunës për njësinë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, atëherë do të kujdestarojmë me dy ndërrime nga 24orë vetëm që të jemi më efikas dhe t'i përgjigjemi thirrjes së qytetarëve. Në bashkëpunim me drejtorinë e bujqësisë do e risim kontrollën në sipërfaqe të pyjeve që i posedon komuna jonë, këtu si faktor kryesor do të ishte angazhimi i punëtorëve shtesë në terren për vëzhgim dhe parandalim të shpërthimit të zjarrit në periudhën korrik-shtator. Në kuadër të vetëdijesimit të qytetarëve për parandalimin e zjarreve fushore-malore dhe çdo lloj tjetër të zjarrit, si çdo vit tjetër edhe këtë vit do të kemi fushatë sensibilizuese ku do të shpérndajmë fletushka nëpër të gjitha shkollat filliore dhe të mesme, në zyret e vendit dhe në vendet më të frekuentuara nga qytetarët, këto fletushka shpjegojnë mënyrën se si të parandalojmë përhapjen e zjarrit si dhe mënyrën e lehtë të fikjes së zjarrit në rast se zjarri është me përmasa të vogla. Apelojmë te qytetarët e komunës së Rahovecit që në këtë kohë mos të shkaktojnë zjarre në ambiente të hapura duke i ndezur hamullaret, stërnishtet në fushë dhe duke u bërë shkaktarë të përhapjes së zjarreve në pyje dhe shtëpi. Kisha pas një kërkesë për të gjithë ju, si anëtarë të këshillit që jeni ta shfrytëzoni autoritetin e juaj që të apeloni në shoqëri të mos kemi zjarrvënie të qëllimshme. Faleminderit.

Fazli Morina – deshta të nderlidhem me pyetjen paraprake për ndriçimin publik dhe për kamerat e sigurisë. Sa për njoftimin tuaj të gjitha kamerat që janë nën kompetencën tonë janë fuksionale kudo çoftë që janë të instaluara edhe pse ndriçim nuk ka.

Kryetari – D.m.th i kemi disa kamera që shihet edhe pa ndriçim publik, por ne jemi të interesuar edhe për ndriçim publik, faleminderit komandant. Pra, meqenëse jemi në prag ku tressiku i zjarreve është më i madh, besoj që drejtori për mbrojtje dhe shpëtim apo njësia e zjarrfikësve ka pajisje dhe përgatitje të mjaftueshme për përbalje me zjarre. Shpresoj që qytetarët e kanë kuptuar që një zjarr i ndezur qëllimshëm është dëm për gjithë ne, në bashkëpunim me drejtorinë, njësinë e zjarrfikësve dhe policinë do të përpinqemi të përballemi me këtë situatë në mënyrë më të suksesshme të mundshme, uroj të mos kemi zjarre. Kalojmë në pikën katër: **4. Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike**, besoj që ka një mori angazhimesh dhe aktivitetesh që na mundësojnë që të ndihemi një komuni pa probleme, ndoshta edhe pa patur nevojë fare t'i diskutojmë raportet ndëretnike. Policia e Kosovës, komuna jonë dhe organet tjera, por edhe KKSB-ja duhet të punojmë që mos të jetë fare temë diskutimi qështja e sigurisë publike dhe rrafshit të marrëdhënieve ndëretnike. Kemi mjaftë vepra dhe kapitale të cilat zhvillohen në një lagje ku ka qytetarë të përzier nga pikëpamja etnike, qofte kanalizim të ujërave të zeza, rrugica, ndriçim publik, vendosjen e kamerave të sigurisë, por edhe aktivitetet tjera të cilat na ndihmojmë që mos të kemi situatë ku mund të kemi keqshfrytëzim nga dikush për qëllime jo të mira. Lendritin e kisha lutur të identifikoj ndonje qështje problematike, ose ndonjë projekt që kishte ndikuar në forcimin e sigurisë publike në reportin ndëretnik.

Lendrit Qeli – Faleminderit kryetar, të nderuar të pranishëm. Përpos asaj që u tha nuk kisha dashur të shtoj më shumë. I kisha veçuar dy projekte në komunën e Rahovecit me të cilat do të kontribuojmë në

qështjen për të cilën po flasim në kuadër të pikës të rendit të ditës, janë dy projekte për të cilën e falënderoj edhe Vjollcën të cilën po e shoh këtu, që do t'i kontribuojmë shoqërisë multietnike në komunën tonë. Komuna e Rahovecit njihet një ndër komunat ku harmonia ndëretnike është në nivelin më të mirë të mundshëm dhe çdo ditë marrim lëvdata në këtë drejtim, kjo falë bashkëpunimit të mrekullueshëm me të gjitha institucionet. Sa i përket këtyre dy projekteve, është një projekt që mbështetet prej komisionit european në implementim të "Carry international" dhe "SHL Kosova" në të cilën përfshihet edhe pjesëtarët e komuniteteve joshumicë dhe komuniteteve të tjera me qëllim të socializimit të tyre dhe në zbutjen e paragjykimeve në mes vete dhe në të njëjtën kohë të forcojë mundësinë e punësimit përmes punës praktike dhe aktiviteteve tjera që kontibojnë në fushën e rinisë. Projekti i dytë "Made for you" i mbështetur nga ambasada japoneze në bashkëpunim me ministrinë e administritimit të pushtetit lokal dhe bashkëpunëtorëve tjerë, parashev që të ketë projekte të tillë të ngajashme për forcimin ndëretnik për komunitete që ne në këtë rast kemi zgjedhur shkollën "Gëzim Hamza- piktori" në bashkëpunim me drejtorin do të shohim mundësinë e mbështetjes së sallës së sporteve ku do të shfrytëzohet prej të gjitha komuniteteve që jetojnë aty dhe besoj që është prej shkollave më të përshtatshme për shkak se janë afér të gjitha komunitetet joshumicë, përfshirë edhe komunitetin shumicë. Ndërsa për pikat tjera, kryetar nëse më lejohet; me të marrë informacionin që i kemi sa i përket ndriçimit publik në lagjen e epërme në fshatin Hoçë një pjesë, kemi informacione që njësiti janë duke punuar në këtë drejtim, ndërsa sa i përket pjesës së epërme, çuditërisht kryetar, sa herë të intervenojmë aty kësia ka punime për të cilat as nuk ka përgjigjet me emala e as me telefonata, fatkeqësia është se aty kemi pas edhe mbështjete të donatorëve të tjerë, në këtë rast nga IOM, pothuajse sa i kemi vendosë brenda javës kësia ka pas punime. Pra, kjo është ajo përgjigja qe e kam për detyrim pjesëtarëve të komunitetit tim t'i shpjegoj në këtë formë që me qenë sa më i kuptueshëm. Sa i përket qendrës, qe jemi duket provuar t'a shtojmë edhe një në shkollën e epërme "Gëzim Hamza- piktori" ka kryesisht për qëllim forcimin e gjendjes së komuniteteve romë, ashkalinjë, egjiptianë mënyrë që mos të mbesim mbrapa me procesin dhe nuk kemi për koncept t'i għeo izojmë këta pjestarë të komunitetit të shkollohen veçmas, qëllimi është t'a rrisim performancën e tyre, në mënyrë që në të ardhmen ata të trajtohen në menyrë të barabartë. Faleminderit shumë.

Kryetari – Faleminderit shume Lendrit, zyra komunale për komunitete dhe kthim dhe cilido prej jush mund t'i adresoheni edhe kryetarit të komunës që është edhe kryesues i KKSBS-së për identifikimin e ndonjë aktiviteti që mund të zhvillohet dhe që mund të ndikoj në begatimin e argumenteve për siguri edhe më të madhe publike ndërmjet qytetarëve qe e kemi obligim t'i trajtojmë barabartë. Meqenëse po hyjmë në sezonën e verës, mund të identifikoni ndonjë lojë (turne: futboll, volejboll) në bashkëpunim me OSBEN-në e cila gjithmonë është e gatshme qe i falenderoj shumë për angazhim dhe të cilët po e përcjellin këtë seancë tanë Muhamet dhe Mati. Faleminderit shumë. Këtu nuk ka ide për racizëm siç thotë Bujari, sepse këto gjëra i kemi kaluar bukur qe disa vite dhe nuk ka praktikë, mund të ketë raste periferike edhe pa qëllim. Por ndaj racizmit, terrorizmit, ekstremizmit që i bëjnë dëm vendit dhe që acarojnë raporte duke krijuar situata anarkike është normale që ne jemi kundër, unë jam i pari që jam kundër prej çfarëdo tentative t'i ndajmë njerëzit në grupe, zona dhe përkatësi. Republika e Kosovës me kushtetutë dhe ligjet e veta ka krijuar një situatë shumë të volitshme për pakicat në Kosovë që vështirë t'i ketë ketë më të rregulluara ndonjë vend në botë. Unë i kam parimet dhe praktikat e mia të punës, problemet të cilat zyra komunale për komunitete dhe kthim t'i kthej, unë nuk shkeli mbi zyrën sepse ajo është zyrë e komunës së Rahovecit, prandaj ju lutem problemet që nuk mund t'i zgjidhni me zyrë, ejani me Lendritin takohemi edhe me drejtorët e drejtorive etj... Po adresë jashtëzakonisht serioze e keni adresën zyrën komunale për komunitete dhe kthim, në këtë rast shefi i kësaj është edhe pjesë e këtij organi i miratuar nga kuvendi i komunës. Nuk t'a jap fjalën Egzon, mos nxirr konkluzua, ulu një herë dhe dëgjom, të lutem mos bën komente se unë personalisht të kam sponsorizuar të jesh anëtar i KKSBS-së sepse e kemi kuptuar që kemi nevoj përfaqësim shtesë, kriteri është mbledhja e nënshkrimeve dhe kemi lobuar i kemi thënë atyre që jepjani nënshkrimet Egzonit, asnje keqkuptim nuk duhet të keni, sepse nuk e kryeni rolin e përfaqësuesit nëse nuk komunikoni si duhet me zyrën komunale për komunitete. Të lutem mos më ndërhy, nuk jemi duke folur në "han të kaçit" këtu, kur ta jap fjalën e merr dhe kurr mos ndërhy deri në momentin që ta jap fjalën sepse jam kryetar i komunës dhe kryesues. Disiplina institucionale është kjo në qoftëse nuk të

pëlqen mundesh me lëshu sallën, të qes jashtë sepse këtu nuk jemi në lagje por në institucion, a e kupton? Nuk e merr fjalën deri në momentin që ta jap, e tash merre fjalën dhe kujdes çka po flet!

Egzon Hamza – Desha të falënderoj që u prezantove sa i përket ndriçimit publik, të kemi pak mirëkuptim z. kryetar, sepse kjo i bie si ofendim ndaj asaj që po flas, desha të them le të jetë pak më i sigurt, sepse i thotë qytetarëve se keku qëllimi sh e ka ndalur rrymën, kontaktova me kekun: përgjigja e tyre ishte se nuk është problemi te ne, por mund të jetë siguresa. E pyeta Përparimin dhe më tha që është e vertetë që është siguresa, le të jetë pak më i drejtë dhe mos të bejë hajgare me qytetarë. Këtë dëshiroja t'a ceku dhe të falënderoj përgjigje dhe që së shpejti do të merr masa ndaj kësaj dukurie sepse është lagje goxha e frekuentuar. Kërkoj falje nëse është kthyer pak në banalitet, patëm keqkuptime të ndërsjella. Nëse ma pranon kërkim faljen mirë, nëse jo, jam në gjendje të jap dorëheqje.

Kryetari – Faleminderit, nuk të lejoj unë ty, të merr përsipër detyra t'a vlerësosh shefin e zyrës komunale për komunitete dhe kthim, Lendrit Qelin. As ty as askënd, sepse është mekanizmi i cili ka dedikim ligjor për performancë, prandaj leni anash partitë politike në KKSBB sepse ne po flasim për siguri të qytetarëve dhe argumentet që duhet ti dijë qytetari të ndihet më i sigurt. Pse ti duhet ti besosh më shumë kedsit (operator privat) sesa shefit të zyrës komunale për komunitete dhe kthim, i cili përpinqet shumë për zgjidhjen e problemeve të komuniteteve pakicë në këtë rast në lagjen e juaj, prandaj besoju atij që është zyrtar e jo atij që është privat, poashtu kedsit shpesh herë na bënë telashe në shumë situata të ndriçimit publik, na ka djegë pajisje të shumta për shkak të veprimeve të gabuara dhe si kryetar komune jam i pakënaqur me kedsin. Faleminderit shumë për kontributin prej komandantit të stacionit të policisë, OSBES-së, anëtarëve të KKSBS-së, shoqërisë civile, përfaqësues të bashkësive fetare, përfaqësues i shoqatës së afaristëve, faleminderit Lendrit, drejtoreve të pranishëm dhe mos të harrojmë edhe Skënderin që po e bënë një punë mjaftë të mirë.

Mbledhja përfundoj në ora 16.50

Procesuabjtesi

 Agim Hoti



Kryetari i Komunës

 Smail Latifi